

## Vendi i furnizimit të shërbime kundrejt personave të pa-tatueshëm

### Rregulli i përgjithshëm

Referuar dispozitave në fuqi të Ligjit Nr. 92/2014, datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, vendi i furnizimit për furnizimet e shërbimeve kundrejt një personi të pa-tatueshëm, është në të gjitha rastet në Shqipëri, kur shërbimet furnizohen nga furnizuesi, i cili ka në Shqipëri:

- Selinë e aktivitetit të tij ekonomik;
- Një vendndodhje të qëndrueshme nga e cila kryhet shërbimi;
- Ose në mungesë të tyre, banesën apo rezidencën e tij të zakonshme.

Sipas parimit të këtij rregulli, kur marrësi i shërbimit është një person i pa-tatueshem, vendi i furnizimit të shërbimit dhe për pasojë i tatimit, është në Shqipëri, kur furnizuesi i këtij shërbimi, një person i tatueshëm, është i vendosur në Shqipëri.

### Person i pa-tatueshëm marrës i shërbimit është në Shqipëri

- Në rastin kur personi i tatueshëm furnizues nuk është i vendosur në Shqipëri, vendi i furnizimit është në Shqipëri, në vendin ku shërbimi merret (përdoret).
- Në rastin kur personi i tatueshëm furnizues është i vendosur në Shqipëri, vendi i furnizimit është në Shqipëri kur shërbimi përdoret (merret) nga persona të pa-tatueshëm në Shqipëri.

### **KUJDES!**

**Nëse shërbimi merret nga persona të pa-tatueshëm jashtë Shqipërisë, vendi i furnizimit nuk është në Shqipëri, por në vendin e marrësit të pa-tatueshëm.**

### Furnizimi i shërbimeve elektronike kundrejt personave të pa-tatueshëm

Vendi i furnizimit të shërbimeve të telekomunikacionit, të transmetimit dhe shërbimeve elektronike ndaj personave të pa-tatueshëm, pavarësisht vendndodhjes së furnizuesit, janë në Shqipëri kur realizohen në përfitim të personit të pa-tatueshëm që është vendosur apo ka banesën e tij të zakonshme në Shqipëri.

Vendi ku është vendosur furnizuesi	Vendi ku është vendosur marrësi i pa-tatueshëm i shërbimit	Vendi i tatimit
Në Republikën e Shqipërisë	Jashtë Shqipërisë	I pa-tatueshëm në Shqipëri
Jashtë Shqipërisë	Në Shqipëri	I tatueshëm në Shqipëri

Ndër këto shërbime përfshihen:

1. Transferimet dhe koncesionet e të drejtave të autorit, patentave, licencave, markave të prodhimit dhe të drejtave të tjera të ngjashme;
2. Qiradhëniet e mallrave të luajtshme të trupëzuara, me përjashtim të mjeteve të transportit;
3. Shërbime publiciteti;
4. Shërbimet e konsulentëve, avokatëve, inxhinierëve, zyrave projektuese në të gjitha fushat, llogaritarëve;
5. Përpunimi i të dhënave dhe dhënia e informacionit;
6. Transaksionet bankare, financiare dhe të sigurimit apo të ri-sigurimit, me përjashtim të qiradhënies së kasafortave;
7. Furnizimi me personel;
8. Shërbimet e telekomunikacionit;
9. Shërbime të furnizuara në mënyrë elektronike si web-site, web-hosting, mirëmbajtje në distancë e programeve, software, etj.

### Nocioni i përdorimit apo shfrytëzimit efektiv

Kriteret e përdorimit apo shfrytëzimit “faktikisht” dhe “fizikisht” marrin në konsideratë natyrën e çdo shërbimi dhe kushtet sipas të cilave përdoret apo shfrytëzohet secili nga shërbimet e të cilat për t’u përcaktuar sa më qartë vendi i furnizimit, duhet të analizohen rast pas rasti.

Për sqarim të këtij përcaktimi përmendim shembujt e mëposhtëm:

- a) Shërbimet e publicitetit janë kryer në Shqipëri, kur vendi nga i cili shpërndahen spotet publicitare për një publik të synuar, ndodhet në Shqipëri. Fakti që media mund të kapet përtej Shqipërisë nuk ndikon, në rastin kur publiku i synuar ndodhet efektivisht në Shqipëri.
- b) Shërbimet e telekomunikacionit të furnizuara me anë të një linje konsiderohen se përdoren efektivisht në Shqipëri, kur telefoni i klientit që emeton komunikacionin ndodhet në këtë vend. Në rastin e një telefoni celular, përdorimi apo shfrytëzimi efektiv prezumohen të jenë në Shqipëri kur karta SIM është shitur në këtë vend.
- c) Vendi i përdorimit apo shfrytëzimit efektiv të shërbimeve të transmetimit radiotelevizive, të cilat i mundësojnë klientit të shohë transmetimet televizive apo të dëgjojë radio është në Shqipëri, kur aparatet e marrësit që mundësojnë përfitimin e shërbimeve ndodhen në këtë vend, çka përkon në shumë raste me vendin e një pasurie të paluajtshme ku furnizohet akses në këto shërbime.

### Vendi i furnizimit për shërbimet e furnizuara nga ndërmjetës

Vendi i furnizimit të shërbimeve të realizuara nga ndërmjetësit që veprojnë në emër dhe për llogari të një personi tjetër është në Shqipëri, nëse vendi i shërbimit kryesor për të cilin ndërmjetëson ndërmjetësi është në Shqipëri.